



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 220 Prot

Tiranë, më 10.03.2022

V E N D I M

Nr.36, datë 10.03.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 9340, datë 26.5.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 1014 prot., datë 2.11.2021, nga nëpunësi doganor *****, është ngritur pretendimi se, transferimi i tij i përkohshëm për nevoja të institucionit, në pozicionin “Doganier, Zyra Doganore Qafë-Morinë, Tropojë”, Dega Doganore Morinë, Kukës, është i padrejtë, pasi vendi ku transferohet është më shumë se 45 km nga vendbanimi i tij dhe gjendja e tij shëndetësore, e bën të pamundur këtë transferim, prandaj, në këto kushte, ai duhet të kthehet në vendin e tij të punës.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që, pas kryerjes së ristrukturimit të fundit në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpunësi doganor *****, është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 625/176, datë 7.2.2019, në pozicionin “Doganier, Sektori i Kontrollit të Sigurisë”, Dega Doganore Durrës dhe mbi këtë bazë,

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka nxjerrë aktin nr. 7230, datë 23.3.2019, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Veprimet në këtë rast, vlerësohen të kryera në përputhje me rregullat e përcaktuara për rastet e ristrukturimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe dispozitat e legjislacionit doganor (pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të posaçme të Kodit Doganor, zbatohen edhe rregullat e parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Disa kohë, pasi ka marrë emërimin e mësipërm, nëpunësi në fjalë, për nevoja të institucionit, me aktin nr. 9340, datë 26.5.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësi në fjalë, është transferuar përkohësisht në pozicionin *“Doganier, Zyra Doganore Qafë Morinë, Tropojë”*, Dega Doganore Morinë, Kukës.

Nëpunësi doganor *****, duke pretenduar që transferimi i mësipërm është i padrejtë, pasi vendi ku transferohet është më shumë se 45 km nga vendbanimi i tij, si dhe gjendja e tij shëndetësore e bën të pamundur këtë transferim, nëpërmjet një kërkesë drejtuar titullarit të institucionit, ka kërkuar kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës si *“Doganier, Sektori i Kontrollit të Sigurisë”*, Dega Doganore Durrës, kërkesë të cilës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i është përgjigjur se, transferimi është kryer në zbatim të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, dhe kushteve të përcaktuara në Kodin Doganor, në lidhje me transferimet e përkohshme të punonjësve doganorë (*shkresa kthim përgjigje nr. 9340/2, datë 9.7.2021*). Kjo përgjigje është dhënë në kohën që nëpunësi ishte me raport mjekësor, dhe sipas vërtetimeve mjekësore që shoqërojnë këtë kërkesë, ai ka vazhduar me raport mjekësor deri në datën 18.11.2021.

Duke mos qenë dakord me qëndrimin e institucionit, si dhe me mosveprimin e këtij të fundit për kthimin në pozicionin e tij të punës, nëpunësi në fjalë ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe kthimin në vendin e punës si *“Doganier, Sektori i Kontrollit të Sigurisë”*, Dega Doganore Durrës, ku ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të përkohshëm në këtë rast, që në fillim duhet të evidentojmë faktin që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon që: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të*

administratës doganore, të së njejtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Sic shihet, në germën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është mënjeluar kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës lejohet të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose e copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve, gjë e cila nënkupton që një nëpunës doganor, mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme, pa patur ndonjë kufizim në shpeshhtësi, prandaj në këtë vështrim nuk mund të merret parasysh pretendimi që, transferimi i përkohshëm është i padrejtë për shkak se, është kryer në kushtet kur kërkuesi ka një emërim definitiv pas ristrukturimit të institucionit.

Po kështu i pabazuar gjendet edhe pretendimi se, transferimi i përkohshëm në një pozicion pune mbi 45 km larg vendbanimit të tij, vjen në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 48, pika 3/b, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Edhe në këtë rast, Kodi Doganor, ka parashikuar rregulla të posaçme, dhe konkretisht, në pikën 7, shkronja “b”, të nenit 15, të këtij kodi, përcaktohet: “*Transferimi mund të bëhet në një nga departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në degët doganore apo pranë strukturave të tjera ku atashohen sipas ligjit, punonjës doganorë*”.

Sic shihet, edhe në këtë dispozitë, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 3/b, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës, *nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil*. Sipas dispozitës në fjalë, një punonjës doganor mund të transferohet kudo në strukturat doganore apo në degët doganore, pa patur ndonjë kufizim përse i përket distancës nga vendbanimi në vendin ku transferohet, mjafton që të jetë Degë Doganore apo struktura të tjera ku atashohen punonjës doganorë.

Heqja e kufizimit të distancës së transferimit të përkohshëm për nevoja pune të nëpunësve doganorë, është shoqëruar me disa masa lehtësuese, siç është përfitimi i kompensimit të qirasë së banesës, sipas rregullave të përfitimit të vendosura në aktin nënligjor (pika 7, e Vendimit nr. 9, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”), masa të cilat duhet të mbahen parasysh nga institucioni edhe në rastin e këtij transferimi.

Më tej, duke e parë në brendësi përmbajtjen e aktit nr. 9340, datë 26.5.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, rezulton se, transferimi i përkohshëm, vërtet është bërë për nevoja të institucionit (*pika 7, shkronja "a" (i), e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i RSH"*) por në akt nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur afati i transferimit. Në lidhje me këtë mangësi, nga ana e institucionit arsyetohet se, meqë dispozita referuese e aktit e parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të një transferimi të përkohshëm, kohëzgjatja prezumohet që nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Kjo mangësi vlerësohet si një element paligjshmërie i aktit të transferimit, pasi si rregull në akt duhet të përcaktohet në mënyrë të shprehur koha e transferimit të përkohshëm dhe data e kthimit të nëpunësit në pozicionin e mëparshëm, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme, duke i siguruar nëpunësit mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së tij.

Nga ana tjetër, pavarësisht se nga pikëpamja formale, akti nr. 9340, datë 26.5.2021, i transferimit të përkohshëm, është në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor, rezulton që nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, nuk është bërë ndonjë hetim për gjendjen shëndetësore të nëpunësit, edhe pse ai menjëherë pas daljes së urdhërit të mësipërm, për shkak të shqetësimeve me karakter shëndetësor, ka paraqitur raport të zgjatur për paaftësi të përkohshme në punë. Konkretisht, nga dokumentacioni mjekësor që shoqëron kërkesën, rezulton se në periudhën 24.6.2021, deri në 18.11.2021, pra, pas daljes së urdhërit të transferimit (*pasi ka konsumuar lejen e zakonshme 27.5.2021 – 10.6.2021*), ai ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë, që janë lëshuar fillimisht, nga Mjeku i Familjes e më pas nga Komisioni Mjeko-Ligjor. Në bazë të pikës 3, germa "a", të nenit 48, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, gjendja jo e mirë shëndetësore e nëpunësit, provuar me vërtetim mjekësor, është një nga rastet e pakta të parashikuara, kur mund të kundërshtohet urdhëri i titullarit të institucionit për transferim të përkohshëm. Në këto kushte, vlerësohet se kjo është një rrethanë e cila nuk duhej të ishte anashkaluar nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, e cila ka për detyrë ta vlerësojë situatën dhe të njoftojë për këtë drejtuesin e institucionit.

Ndërkohë, konstatohet se, institucioni jo vetëm që nuk ka reaguar për të analizuar situatën, por në këtë moment të hetimit administrativ, rezulton se, afati 6-mujor i transferimit të nëpunësit *****, ka përfunduar në muajin Nëntor 2021 dhe tashmë është tejkaluar. Në këto kushte, si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, duke theksuar faktin se, nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme, të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet e transferimit dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë

dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës “Doganier, Sektori i Kontrollit të Sigurisë”, Dega Doganore Durrës, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, në zbatim të shkronjës “a”, pika 7, të nenit 15, të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha